

Njoftim per te strehuarit

Drejtori ose asistentet e shoqerise qe ju strehon mund t'ju thojne ose mund t'ju kene thene me perpara per tu larguar nga qendra e strehimit kur ky i fundit do te mbyllet ne muajin Mars. Ja çfare duhet te dini :

Ne qofte se ju thone qe qendra do te mbyllet :

Ligji mbi strehimin thote qe nuk kemi te drejte te largojme dike nga qendra e strehimit ne qofte se personi nuk ka zgjidhje tjeter per strehim. Domethene, asnjeri nuk ka te drejte t'ju largoje nga qendra e strehimit ku banoni. Ne qofte se largoheni nga strehimi, prefektura e konsideron qe eshte zgjedhja juaj e largimit prej qendres, domethene ajo s'eshte e detyruar t'ju gjeje nje strehim tjeter.

Ne qofte se ju thone qe duhet te largoheni nga strehimi prej shkak te situates tuaj te parregullt ne France :

E drejta e strehimit eshte e pakushtezuar, domethene qe nuk varet nga situata juaj administrative. Edhe pse kerkesa juaj ndaj OFPRA per azil ose kerkesa e lejeqendrimit eshte refuzuar nga prefektura, ose kerkesa e rekursit jane refuzuar dhe ne qofte se ju ka ardhur vendimi per tu larguar nga Franca, (OQTF), nuk ndryshon gje : ju keni gjithmone te drejten e strehimit. Drejtori ose asistentet e shoqerise qe ju strehojne, nuk mund t'ju nxjerrin jashte.

Ne qofte se policia vjen t'ju largoje nga strehimi ose t'ju ndaloje per t'ju larguar nga Franca :

Ligji lejon policine te hyje ne qendren e strehimit me lejen e drejtorit por eshte e ndaluar qe ata te hyjne ne dhomat tuaja pa autorizimin e gjykates (komisjoni i urdherave). Ka shume pak shance qe gjykata te japi kete urdher vetem pse qendrimi juaj eshte i parregullt. Ju keni te drejten te mbylleni ne dhomen tuaj edhe mos t'ja hapni deren policise ose çdokujt tjeter personi.

Gjithashtu, pjesa ku jeni strehuar konsiderohet si shtepia juaj. Per t'ju larguar, duhet nje vendim i gjykates. Sot, ne qofte se ndonjeri vendos te qendroje te vend-strehim edhe pse data e largimit ka kaluar, policija mund te nderhyje vetem kur vendimi i proçedures juridike per tu larguar merret. Duhet shtuar qe ky vendim, ne pergjithesi, kerkon kohe te gjate.

Ne qofte se ju ka ardhur vendimi per tu larguar nga Franca (OQTF) :

Policija nuk ka te drejte t'ju perzeje nga territori francez ne qofte se vendimi i largimit (OQTF) nuk eshte i ekzekutueshem, domethene para fundit te perjudhes te shkruar mbi dokument (30 dite ose 48 ore). Ju mund te kundershтони vendimin e largimit (OQTF) me ndihmen e nje avokati per ta anuluar. Kjo proçedure eshte falas per personat qe kane shume pak te ardhura ose nuk kane fare sepse ato mund te perfitojne nje ndihme juridike.

Kujdes ! Per personat qe kane adresen e vendbanimin ne platformen e Relievit : Sigurohuni qe vendimi i largimit (OQTF) nuk ka ardhur ne platformen e Relievit, sepse punetoret e qendres mund te marrin posten ne vendin tuaj dhe mund te firmosin ne vendin tuaj. Por, data e marrjes se postes eshte data e fillimit te proçedurave per tu larguar ose data e fillimit te proçedurave per gjykatën administrative per te anuluar largimin nga territori francez.

Ne te gjitha rastet, ne qofte se keni nje avokat, mund ti kerkoni te nderhyje ne shoqaten qe ju strehon qe e drejta juaj e strehimit te respektohet.

Ne qofte se ju kane thene gojarisht te largoheni nga strehimi, ju mund te kerkoni qe kjo kerkese te behet me poste ne menyre zyrtare (duke ju bere te ditur ditën qe ju eshte kerkuar te largoheni nga strehimi).

Ne qofte se ju detyrojme te largoheni nga strehimi edhe ju gjendeni ne rruge, ju mund ti kerkoni avokatit te beni nje kerkese per te drejtat e juaja : eshte nje proçedure perballë drejtesise qe ju lejon ne disa raste per te gjetur nje strehim.

Ne qofte se personeli i shoqates qe ju strehon tenton t'ju largoje nga vend-strehimi ose ne qofte se policia tenton t'ju arrestoje, ju mund te telefononi ne numrin e urgjences : 07 58 23 00 69 (Lycamobile)